



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS **KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI**

Nr.Prot.	01/2023
Për:	Kryesuesin e Kuvendit të Komunës së Suharekës- z. Bexhet KUÇI
Nga:	Kryetari i Komunës në Suharekë njëherit Kryesues i KKSBB-së
Lënda:	Informatë për aktivitet e KKSBB-së për periudhën Janar-Qershor 2023
Datë:	05.07.2023

Nga takimet e Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive “KKSBB” në Komunën e Suharekës, të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal 27/2012, MPB dhe 03/2012, MAPL për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi KKSBB, ju dërgojmë këtë:

I N F O R M A T Ë

Pas konstituimit të organeve të Komunës në Suharekë, të daluar nga zgjedhjet lokale të vitit 2021, Kuvendi i Komunës në muajin janar të vitit 2022, ka themeluar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB-në), konform Ligjeve dhe akteve tjera nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës, si organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB-ja) për periudhën Janar-Qershor të vitit 2023, ka mbajtur tri (3) takime të rregullta dhe ato konform planit të veprimit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Suharekës.

Në këto takime kanë marrë pjesë kryesisht shumica e anëtarëve të KKSBB-së.

Në takimin e parë (1) të rregullt, të mbajtur me datën 10.02.2023, tema diskutimi kanë qenë:

- **Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës;**
- **Ushtrimi i kontrollit më të shpeshtë të trafikut rrugor për të zvogëluar aksidentet me fatalitet;**
- **Organizimi i trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënës të shkollave;**

Sa i përket vlerësimit në territorin e Komunës së Suharekës, ne konsiderojmë se kemi një situatë të qetë, ku e bazojmë në raportin e vitit 2022. Ulja e kriminalitetit ka qenë: -12.5 % krahasuar me vitin 2021. Vepra penale: 617 në vitin 2021 dhe 516 në vitin 2022. Vrasje: 0 raste në vitin 2021 dhe 0 raste në vitin 2022. Dhunë familjare: 77 raste në vitin 2021 dhe 60 raste në vitin 2022. Tentim vrasje: 1 rast në vitin 2021 dhe 0 raste në vitin 2022. Lëndim i lehtë trupor: 59 raste në vitin 2021 dhe 46 në vitin 2022. Vjedhje e rëndë: 74 raste në vitin 2021 dhe 54 raste në vitin 2022. Vjedhje: 78 raste në vitin 2021 dhe 63 raste në vitin 2022. Grabitje: 2 raste në vitin 2021 dhe 1 rast në vitin 2022. Dëmtim prone: 81 raste në vitin 2021 dhe 54 raste në vitin 2022. Shkak i rrezikut të përgjithshëm: 14 në vitin 2021 dhe 4 në vitin 2022. Zbulueshmëria: 78.4 % në vitin 2021 dhe 79.4 % në vitin 2022. Aksidente: 320 raste në vitin 2021 dhe 304 raste në vitin 2022. Urdhëresat: 950 në vitin 2021 dhe 953 në vitin 2022. Tikitat: 9040 në vitin 2021 dhe 13522 në vitin 2022. Patrullimet: 4163 në vitin

2021 dhe 4274 në vitin 2022. Pika kontrolli: 2607 në vitin 2021 dhe 2651 në vitin 2022. Bashkëpunimet me institucionet tjera janë të shkëlqyera dhe ky bashkëpunim do të forcohet edhe më tepër.

Policia e Kosovës me qëllim të parandalimit të aksidenteve, vazhdimisht ka ofruar kampanja të ndryshme senzibilizuese. Vitin e kaluar kemi pas tre aksidente me fatalitet. Pas çdo aksidenti me fatalitet ne bëjmë një analizë sepse e kërkon edhe Prishtina. Gjithmonë kërkohet sa ka qenë patrullimi në atë zonë. Ne kemi mbajtur ligjërata nëpër shkolla për sigurinë në trafik, sidomos për këmbësor dhe do të vazhdojmë edhe 2023-tën. Kemi një problem në hyrje të zona industriale ku atje nuk përdoret nënkalimi nga nxënësit. Pastaj kemi edhe zona tjera ku do të potencioja edhe problemin e shenjzimit dhe sinjalizimit dhe nëse është e mundur sa më shpejtë të bëhen dhe të jenë sa më të theksuara me qëllim që të mos kemi aksidente me fatalitet. Ne si polici do të marrim veprimet dhe ju si komunitet mund të na ndihmoni me idetë tuaja se ku ka nevojë policia me qenë më prezentë.

Në kuadër të planit të veprimit për vitin 2023 FSK-ja do të trajnoj nxënëset e shkollave të mesme nëpër Komuna, aty ku e shoh të nevojshme apo të domosdoshme për parandalimin e zjarreve kudo që e shohin të arsyeshme.

Konkluzion apo rekomandim nga ky takim ka dalë:

- *Të vazhdohet dhe të rritet sa më shumë bashkëpunimi në mes policisë dhe komunitetit.*
- *Bashkëpunimi në mes të Drejtorisë së Urbanizmit dhe policisë për sinjalizimin e rrugëve.*
- *Të ngritët vigjilenca e policisë sa i përket kontroleve në pikat më të rrezikuara.*
- *Drejtoria e Arsimit t'i adresohet FSK-së dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike që ta bëjë një plan të orarit për trajnime për parandalimin e zjarreve.*

Në takimin e dytë (2) të rregullt të mbajtur me datën 14.04.2023, tema diskutimi kanë qenë:

- **Analizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Suharekës;**
- **Vetëdijesimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjeteve të tjera të pa shpërthyer nga lufta;**
- **Identifikimi dhe lirimi i hapësirave publike konkretisht trotuareve;**

Sa i përket vjedhjeve në territorin e komunës së Suharekës në bazë të raporteve për tre mujorin e parë kemi rënie të kriminalitetit -18% ose bazuar në vepra penale vitin e kaluar kemi pas 226 vepra kurse këtë vit 185. Rastet e vjedhjeve vitin e kaluar kanë qenë 31 vjedhje dhe tani 22, vjedhje me tentative 8 vitin e kaluar dhe tani 5, vjedhje të rënda vitin e kaluar kanë qenë 20 dhe tani 12. Për tre mujorin e parë kanë qenë 12 raste të zbuluara. Vjedhjet që janë regjistruar në tre mujorin e parë kanë qenë 6 raste në Suharekë, Samadraxha 2 raste, Greikoci 2 raste, Vraniqi 2 raste, Bukoshi, Savrova dhe Peqani nga 1 rast. Sa i përket aktivitetit policor, patrullimet vitin e kaluar kanë qenë 632 tre mujorin e parë dhe 648 në tre mujorin e parë të këtij viti. Patrullimet në këmbë vitin e kaluar kanë qenë 391 dhe këtë vit 399. Nga 611 pika të kontrollit tani kemi 621 pika të kontrollit. Kemi sektorin e hetimeve ku e bën vazhdimisht monitorimin e gjendjes dhe hetim të gjendjes me rroba civile. Lusim qytetarët që të rrisin bashkëpunimin me policinë të japin informacione për persona të dyshimtë.

Konkluzion apo rekomandim nga ky takim ka dalë:

- *Edhe më tutje le të vazhdojë bashkëpunimi në mes përfaqësuesve të komiteteve dhe policisë dhe çdo rast që vlerëson dhe konsideron qytetari që është e rrezikshme ta paraqesin në polici.*
- *Drejtoria e arsimit të bëjë kërkesë në Ministrinë e Mbrojtjes për trajnimin dhe mbajtjen e ligjëratare për nxënës dhe qytetarë, që ta mbaj një aktivitet lidhur me mjetet e pashpërthyer aty ku drejtoria e arsimit e shfsh të nevojshëm dhe të arsyeshme.*

- *Të bëjnë kontroll të vazhdueshme në qytetin e Subarekës dhe për rreth në bashkëpunim me Inspeksionin me qëllim të zhbllokimit të trotuareve nga parkimet e automjeteve në vendet e pa lejuar për parking si dhe nga gjësendet e ndryshme.*

Në takimin e tretë (3) të rregullt të mbajtur me datën 15.06.2023, tema diskutimi kanë qenë:

- **Diskutim për aktivitetet e organizuara nga Drejtoria e Arsimit për maturanët;**
- **Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm;**
- **Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror;**
- **Plani operativë për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave;**

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Arsimit, ne i kemi zhvillu të gjitha procedurat dhe jemi në rrjedha të përfundimit të këtij viti mësimor. Sipas informatave që kemi marrë nga shkollat këtë vit shkollor janë 534 maturanë. 247 janë në gjimnazin “Jeta e Re”, 182 në shkollën “Skënder Luarasi”, 105 në shkollën profesionale “Abdyl Rama”. Janë bërë të gjitha përgatitjet për testin e maturës i cili do të mbahet me 24 qershor. Janë përcaktua 4 objekte shkollore ku do të mbahet testi i maturës dhe do të jenë 5 qendra. Besoj që ky proces do të rrjedh normalisht sepse janë disa vite që ky proces po zhvillohet pa asnjë incident. Po ashtu maturanët e kanë kryer ekskursionin në Shqipëri dhe sipas informatave, profesorët kanë shpreh admirimin më të mirë për sjelljen dhe disiplinën për këta fëmijë. Javën e kaluar janë realizuar dy mbrëmje të maturës, të gjimnazit “Jeta e re” dhe shkollës “Skënder Luarasi” ku sipas informatave çdo gjë ka shkuar mirë, ndërsa nesër pritet të realizohet mbrëmja e maturës për shkollën “Abdyl Rama”.

Sa i përket prishjes së rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm situatën në përgjithësi e kemi të qetë me prijashtim të ndonjë rasti i cili pas njoftimit që bëhet nga qytetaret policia e Kosovës menjher këto raste i ndalon me qëllim që te ju krijohet kushte për jetës dhe siguri qytetareve.

Konkluzione apo rekomandime nga ky takim ka dalë:

- *Të rritet bashkëpunimi me qytetarët dhe policinë;*
- *Policia së bashku me inspektoratin ta ngrisin vigjilencën gjatë periudhës sa janë mërgimtarët por jo duke përjashtuar vazhdimin e ngritjes së vigjilencës së kontrollimit dhe mbajtjes nën kontroll të të gjitha lokaleve të cilët punojnë më tepër se sa është e përcaktuar me fillimin dhe mbarimin e orarit të punës.*
- *Të ngritet vigjilenca nga ana e policisë për ruajtjen e sigurisë dhe qetësisë për sezonin veror; Motoja të jetë publike “Festo me zemër dhe jo me armë” gjatë abengjeve familjare;*
- *Konkluzion tjetër apo rekomandim nga ky takim ka qenë që të shtohet numri i zjarrfikësve gjatë sezonit të verës, të merren masa preventive për mos djegien e fushave, të njoftohen me shkrim pishinat për raste emergjente për furnizim me ujë nga pishinat dhe në raste emergjente të bashkëpunohet me FSK;*
- *Të ngritet vigjilenca e policisë, sidomos në pikat e rrezikshme dhe ti frekuentojmë më shpesh lidhur me respektimin e shenjave të komunikacionit.*

Me respekt!

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ